

## Takim me grupin e ekspertëve

Më datën 23 Shkurt 2017, u zhvillua takimi i dytë me ekspertët që po punojnë për iniciativat e ndryshimet ligjore e nënligjore për aksesin e grave në të drejtat pronësore.

Në këtë mbledhje, përveç ekspertëve dhe përfaqësuesve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, ishin prezentë përfaqësues nga UN Women dhe Ministria e Drejtësisë, Drejtorja e Projekteve.

Mbledhja kishte në fokus diskutimin e propozimeve të përgatitura nga një pjesë e ekspertëve lidhur me ndryshimin e legjislacionit aktual në lidhje me përfshirjen e aspektit gjinor. Diskutimet kishin në fokus të tyre mundësinë e përfshirjes së këtyre propozimeve, si dhe efektet që ato do të sillnin në të ardhmen. Pjesëmarrësit analizuan me detaje përshtatjen e terminologjive juridike, në mënyrë që të mos sjellë kuptime të ndryshme në zbatimin e tyre nga organet publike.

Secili propozim mori vëmendjen e duhur, nëpërmjet ndërthurjes së analizës teorike dhe pasqyrimin të fakteve praktike, diskutimit të pasojave që sjell mungesa e qartësisë së dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat kanë sjellë mohimin ose kufizimin e përfitimit të të drejtave pronësore nga bashkëshortet. Gjatë tryezës, u dhanë disa rekomandime të cilat lidheshin me punën lobuese për miratimin e propozimeve të paraqitura.

Për rishikimin e propozimeve të përgatitura u caktua afati deri më datën 05 Mars 2017.

